

Përmbledhje

Eurozona është karakterizuar me rikuperim gradual të kërkesës së brendshme. Ky rikuperim është ndikuar nga përmirësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimit të kushteve në tregun e punës dhe çmimeve të ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor në muajt e parë të vitit 2016, që u karakterizuan me rritje të eksporteve dhe investimeve.

Ngjashëm me eurozonën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë është duke u nxitur kryesisht nga përforsimi i kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve. Parashikimet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.6 përqind.

Zhvillimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve vazhdojnë të karakterizohen me presione të lehta deflacioniste. Përkundër normës pozitive të inflacionit prej 0.1 përqind në tremujorin e parë të vitit 2016, tremujori i dytë u karakterizua me normë negative të inflacionit prej (0.2 përqind).

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Deri në qershor të vitit 2016, buxheti i Kosovës regjistroi suficit buxhetor prej rreth 20.3 milionë euro, krahasuar me deficitin buxhetor prej rreth 21.1 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Bilanci i pagesave në Kosovë shënoi rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, kryesisht si pasojë e rënies së eksportit të mallrave (5.6 përqind) dhe rritjes së importit (8.3 përqind). Gjithashtu, rënia e të ardhurave nga kompensimi i

punëtoreve dhe rënia e remitencave të pranuar në vend ndikoi në përkeqësimin e llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, rritja e eksportit dhe rënia e importit të shërbimeve ndikoi në rritjen e bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve. Sa i përket llogarisë financiare, investimet e huaja direkte edhe gjatë tremujorit të dytë vazhduan të shënojnë vlera më të ulëta në krahasim me vitin paraprak.

Spektori bankar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 u karakterizua me rritje të aktivitetit kredidhënës (8.4 përqind), si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi dhe përmirësimit të kushteve të kreditimit nga ana e bankave. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat shënuan një rritje vjetore prej 4.6 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi zbriti në 7.2 përqind, duke nxitur kështu kërkesën për kredi si nga ndërmarrjet ashtu dhe nga ekonomitë familjare. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita shënoi një ngritje të lehtë duke arritur në 1.0 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të zvogëlohet edhe gjatë tremujorit të dytë, duke zbritur në 5.3 përqind në qershor 2016, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të kenë gjendje të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, vërehet përmirësim më i theksuar te sektori mikrofinanciar, përderisa edhe sektori pensional realizoi kthim pozitiv nga investimet, mirëpo më të ulët në krahasim me vitin paraprak. Në anën tjetër, sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe shënoi thellim të humbjes.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	04
Ekonomia e Kosovës	06
Sektori Real	06
Sektori Fiskal	09
Sektori i Jashtëm	09
Sistemi Financiar	13
Sektori Bankar	13
Sektori Pensional	21
Sektori i Sigurimeve	22
Sektori Mikrofinanciar	23
Tregu i Letrave me Vlerë	26

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë	04
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së	05
Figura 3. Norma e inflacionit	07
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë	07
Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit	07
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit	07
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit	08
Figura 8. Regjistri i bizneseve	08
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja	08
Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	10
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive	10
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive	11
Figura 13. Remitencat	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte	12
Figura 15. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik	12
Figura 16. Asetet e sistemit financiar të Kosovës	13
Figura 17. Asetet e bankave komerciale	13
Figura 18. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	14

Figura 19. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	14
Figura 20. Kreditë sipas sektorëve ekonomik -----	15
Figura 21. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	15
Figura 22. Kreditë sipas afatit të maturimit -----	15
Figura 23. Depozitat -----	16
Figura 24. Struktura e depozitave -----	16
Figura 25. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	16
Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	17
Figura 27. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	17
Figura 28. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	18
Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozita -----	18
Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje-----	18
Figura 31. Profiti neto i sektorit bankar-----	19
Figura 32. Vlera e të hyrave sipas kategorive -----	19
Figura 33. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive dhe rritja vjetore e shpenzimeve -----	19
Figura 34. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	20
Figura 35. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	20
Figura 36. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së NPL-ve -----	20
Figura 37. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	21
Figura 38. Asetet e sektorit pensional -----	21
Figura 39. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	22
Figura 40. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	22
Figura 41. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 42. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive-----	24
Figura 44. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	24
Figura 45. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	24
Figura 46. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	25
Figura 47. Norma mesatare e interesit në kredi sipas sektorëve ekonomik -----	25
Figura 48. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	25
Figura 49. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	25
Figura 50. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	26
Figura 51. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	26
Figura 52. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit-----	27
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	04
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës -----	26
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	29


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Eurozona ka vazhduar rikuperimin në gjashtë muajt e parë të vitit 2016. Në TM2 2016, rritja vjetore e BPV-së në eurozonë mbeti e pandryshuar nga viti paraprak në 1.6 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme (figura 1). Politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit në eurozonë. Për më tepër, përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës dhe çmimet e ulëta të naftës janë përkthyer në rritje të të ardhurave të disponueshme, duke ndikuar kështu në rritjen e konsumit të brendshëm. Megjithatë, në tremujorin e dytë të vitit 2016, si pasojë e pasigurive të ngritura rreth rezultateve të referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për dalje nga BE-ja, besueshmëria e bizneseve në eurozonë u përkeqësua.

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2016)

Rritja ekonomike në eurozonë në TM2 2016 kundrejt periudhës së njëjtë në vitin paraprak u mbështet kryesisht nga ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermania (1.7 përqind), Franca (1.4 përqind), Italia

(0.8 përqind) dhe veçanërisht Spanja (3.2 përqind) (tabela 1).


Norma e inflacionit në eurozonë vazhdoi të jetë nën objektivin e BQE-së. Në TM2, shkalla mesatare e inflacionit ishte -0.1 përqind. Masat e reja të ndërmarra nga BQE-ja në mars 2016 në kuadër të programit të lehtësimit sasior kishin si qëllim parësor evitimin e deflacionit dhe rikthimin e shkallës së inflacionit më afër caktimit prej 2 përqind. Megjithatë, ndikimi i politikave ekspansioniste monetare në nivelin e çmimeve në eurozonë ka rezultuar të jetë i kufizuar, kryesisht si pasojë e çmimeve të ulëta të naftës dhe rënies së çmimeve të energjisë në këtë periudhë. Projektionet e BQE-së për vitin 2016, të publikuara në muajin qershor, sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 0.2 përqind.

Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënie të mëdha të normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor (figura 2). Gjithashtu, BQE-ja ka vazhduar të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind.

Rikuperimi i aktivitetit kreditues në eurozonë ka vazhduar edhe në tremujorin e dytë të vitit 2016, i mbështetur nga përmirësimi i kushteve të kreditimit për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare dhe rritja e kërkesës për kredi. Standarde të lehtësuara kreditore raportuan veçanërisht Franca, Italia dhe Gjermania. Rritja mesatare e kreditimit në eurozonë në TM2 2016 ishte rreth 1.1 përqind (0.8 përqind në TM2 2015). Rikuperimi i kreditimit në eurozonë në vitin

2016 është mbështetur si nga rritja e kreditimit për ekonominë familjare (2.2 përqind në TM2 2016), ashtu edhe nga rritja e kredive për ndërmarrjet (1.1 përqind në TM2 2016). Rritja e të ardhurave të disponueshme në eurozonë në këtë periudhë mund të kenë ndikuar në depozitat e rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (8.2 përqind), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (4.5 përqind).

Figure 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2016) dhe BQE (2016)

Gjatë TM2 2016, performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të përforcohet. Rritja kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen prej 3.3 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në TM1 2016. Për vitin 2016, parashikimet e FMN-së sugjerojnë për një normë mesatare të rritjes vjetore të BPV-së prej 3.3 përqind. Me përjashtim të Maqedonisë, të gjitha vendet tjera të rajonit pritët të shënojnë përsheptim të normës së rritjes së ekonomisë (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016
Austria	0.2	0.5	1.0	1.3
Franca	0.3	-0.2	1.1	1.4
Gjermania	0.5	1.4	1.6	1.7
Greqia	-4.6	0.3	0.8	-0.7
Italia	-2.0	-0.3	0.5	0.7
Spanja	-1.7	1.2	3.2	3.2
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	2.8	3.0
Kosova	3.4	1.2	4.0	3.6
Mali i Zi	3.5	1.8	4.1	4.7
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	3.6
Serbia	2.6	-1.8	0.7	1.8
Shqipëria	1.1	2.0	2.6	3.4

Burimi: WEO (2016)

Ngjashëm me eurozonën, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, që kryesisht i atribuohen zhvillimeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Në TM2 2016, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, dhe Maqedonia u përballën me deflacion (-1.5, -1.0, përkatësisht -0.3 përqind), përderisa Serbia dhe Shqipëria regjistruan një shkallë mesatare të inflacionit prej 1.2 përkatësisht 1.9 përqind.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar të vendeve të rajonit, me rritje të aktivitetit kreditues në këtë periudhë u karakterizua veçanërisht Serbia (9.5 përqind) dhe Kosova (8.4 përqind), përderisa rënie të kreditimit shënoi Kroacia dhe Mali i Zi (5.8 përkatësisht 0.2 përqind). Vendet e Ballkanit Perëndimor raportuan edhe për rritje të depozitave. Mali i Zi shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në qershor 2016 (9.3 përqind), përderisa rritjen më të ulët shënoi Shqipëria (2.1 përqind).

Deri në qershor, euro është zhvlerësuar kundrejt valutave tjera të mëdha si dollari, sterlina britanike dhe franku zviceran. Në TM2 2016, norma e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 0.3 përqind, frankës zvicerane dhe sterlinës britanike për 3.9 përkatësisht 6.6 përqind. Zhvlerësimi i euros kryesisht i është atribuar ndikimit të zgjerimit të masave ekspansioniste në kuadër të programit të gjerë stimulues të ndërmarr nga BQE-ja. Në kuadër të monedhave të rajonit, euro është vlerësuar kundrejt denarit maqedon dhe dinarit serb për 0.1 përkatësisht 1.6 përqind, përderisa është zhvlerësuar ndaj lekut shqiptar për 1.5 përqind.

Ekonomia e Kosovës

Sektori real

Ekonomia e Kosovës në vitin 2016, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet të shënojë rritje prej rreth 3.6 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPV-së.

Vlerësimet e ASK-së sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 3.8 përqind në TM1 2016, rritje kjo e gjeneruar nga rritja e investimeve prej 22.1 përqind si dhe rritja e konsumit prej 4.5 përqind. Në këtë periudhë, neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me thellim të konsiderueshëm të deficitit prej 21.2 përqind në terma real. Sa i përket qasjes së prodhimit, rritja vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga ndërtimtaria (rritje prej 8.2 përqind), tregtia (3.1 përqind) dhe hotelet e restorantet (14.0 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë

shënuar tek industria nxjerrëse (8.1 përqind), afarizmi me pasuri të patundshme (4.0 përqind) dhe administrimi publik (2.2 përqind rënie).

Të dhënat deri në qershor 2016 sugjerojnë rritje të disa prej burimeve të konsumit si kreditë konsumuese dhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë. Rritja e konsumit mund të shpjegohet edhe përmes rritjes së importit të mallrave konsumuese, të cilat shënuan rritje prej 9.8 përqind. Në anën tjetër, remitencat, si një burim i rëndësishëm i financimit të konsumit, u karakterizuan me nivel më të ulët kundrejt vitit paraprak (2.7 përqind rënie).


Për sa i përket investimeve, investimet publike deri në qershor të vitit 2016 shënuan rritje prej 16.1 përqind. Poashtu, importi i mallrave kapitale ka shënuar rritje prej 27.6 përqind, që mund të jetë një indikacion për rritjen e investimeve private në këtë periudhë. Në anën tjetër, investimet e huaja direkte si dhe kreditë e reja investuese për ndërmarrjet kanë shënuar rënie.

Me performancë më të dobët deri në qershor 2016 u karakterizua edhe eksporti i mallrave, i cili shënoi rënie prej 5.6 përqind, ndërkohë që importi shënoi rritje të konsiderueshme (8.3 përqind).

Çmimet

Pas shenjave fillestare për një ngritje të nivelit të çmimeve të konsumit (shprehur përmes IÇK-së) në TM1 2016, kur u shënuar një shkallë inflacioni prej 0.1 përqind, në TM2 u rishfaqën tendencat deflacioniste me ç'rast u shënuar një shkallë deflacioni prej 0.2 përqind (figura 3).


Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, në TM2 2016, me rritje u karakterizuan çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (10.2 përqind), pasuar nga çmimet e shërbimeve shëndetësore (3.1 përqind). Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar te shërbimet e transportit (4.5 përqind), pasuar nga kategoria e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (4.0 përqind). Me rënie prej 1.3 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar (figura 4).


Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Indeksi i çmimeve të importit¹ në TM1 2016 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak shënoi rënie prej 4.4 përqind (figura 5).


Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2016)

Çmimet e produkteve minerale, të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit, shënuan rënie më të lartë (18.6 përqind), ndërsa çmimet e vajrave ushqyese shënuan rritjen më të lartë të çmimeve (14.3 përqind) (figura 6).

Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Në TM1 2016, indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rënie prej 0.5 përqind. Rënia e çmimeve më së shumti ishte evidente te prodhimi i

¹ Bazuar në kalendarin e publikimeve të ASK-së indeksi i çmimeve të importit si dhe indeksi i çmimeve të prodhimit për TM2 2016 do të publikohen me 9 përkatësisht 13 shtator 2016.

mjeteve motorike (të transportit) rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, prodhimi i produkteve minerale, nxjerrja e xehes së metalit, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje





Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2016)


Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pothuajse në të gjithë sektorët është shënuar rritje e ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruara prej 140 ndërmarrje më shumë, pasuar nga sektori financiar që u karakterizua me 75 ndërmarrje më shumë.

Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, deri në qershor 2016 është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu rritje e numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 5,697 apo 628 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,384 ndërmarrje apo 448 ndërmarrje më shumë se sa në vitin paraprak (figura 8).

Edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara ishte në sektorin e tregtisë me 1,599 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimitarisë me 677 ndërmarrje, hotelarisë me 575 ndërmarrje dhe bujqësisë me 484 ndërmarrje (figura 9).

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në qershor 2016 arritën vlerën bruto prej 756.2 milionë euro. Nëse zbriten 19.5 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 736.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.0 përqind. Shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 716.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 7.4 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej rreth 20.3 milionë euro krahasuar me bilancin negativ buxhetor prej rreth 21.1 milionë euro deri në qershor të vitit 2015.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje më e lartë e të hyrave kufitare të cilat arritën vlerën bruto prej 473.5 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 17.6 përqind. Të hyrat nga tatimet e brendshme arritën vlerën bruto prej 177.3 milionë euro që paraqet rritje vjetore prej 9.1 përqind.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore indirekte të cilat arritën vlerën bruto prej 545.6 milionë euro (15.5 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore direkte të cilat arritën vlerën bruto prej 116.4 milionë euro (13.8 përqind rritje) dhe të hyrat jo-tatimore, ku përfshihen edhe të hyrat vetanake, të cilat arritën vlerën prej 94.2 milionë euro (8.7 përqind rritje).

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje përveç mallrave

dhe shërbimeve të cilat shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 5.4 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 272.4 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 7.9 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 211.9 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 18.7 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan rritjen më të lartë, prej 16.1 përqind dhe arritën vlerën prej 134.2 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale), shënuan rënie për 2.0 përqind dhe arritën vlerën prej 87.7 milionë euro.

Borxhi publik, në qershor 2016, ka arritur në 821.9 milionë euro që është për 26.6 përqind më i lartë krahasuar me qershor 2015. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 13.8 përqind nga 11.2 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 37.6 përqind (i cili ka arritur në 438.3 milionë euro), ndërkohë që edhe borxhi i jashtëm ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 16.0 përqind duke arritur në 383.6 milionë euro. Përderisa në vitet e kaluara borxhi publik dominohej nga borxhi i jashtëm, në qershor të vitit 2016 borxhi i brendshëm kishte pjesëmarrje prej 53.3 përqind në gjithsej borxhin publik.

Sektori i Jashtëm

Deri në qershor të vitit 2016, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 337.9 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 208.8


² Në kuadër të të hyrave primare nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

³ Në kuadër të shpenzimeve primare nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pagesat nga depozitat në mirëbesim.

milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore. Në anën tjetër, bilanci pozitiv në llogarinë e shërbimeve shënoi rritje.

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 10.4 përqind në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, kryesisht si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve. Eksporti i mallrave në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016 kishte vlerën prej 152.4 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 5.6 përqind (rritje prej 14.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2015) (figura 10).⁴

Figura 10. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2016)

Rënia e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rënies së eksporteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e gjithsej eksporteve të vendit (rreth 40 përqind) (figura 11).

Rënia e vlerës së gjithsej eksporteve të metaleve bazë u zvogëluua kryesisht si pasojë e rënies së prodhimit të nikelit në ekonominë e vendit, si dhe rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Me rënie u karakterizuan edhe eksportet e tekstilit dhe artikujve të tekstilit, si dhe eksportet e makinerive dhe pajisjeve elektrike. Në anën tjetër, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016, eksportet e produkteve minerale shënuan rritje, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së eksportit të energjisë elektrike. Gjithashtu, eksportet e produkteve të plastikës dhe gomës, si dhe eksportet e produkteve të lëkurës shënuan rritje në periudhën raportuese.

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në gjashtëmuajorin e parë 2016 arriti në 1.3 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.3 përqind. Në kuadër të importit të mallrave, me rritje u karakterizua importi i metaleve bazë, importi i makinerive dhe i pajisjeve mekanike dhe elektrike, importi i mjeteve të transportit si dhe importi i produkteve ushqimore (figura 12). Rënia e vlerës së eksporteve dhe rritja e vlerës së mallrave të

⁴ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

importuara rezultoi në zvogëlim të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.7 përqind në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016 (13.5 në gjashtë muajt e parë të vitit 2015).


Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 171.3 milionë euro deri në qershor të vitit 2016, një rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak prej 29.4 përqind. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara në këtë periudhë shënoi rritje vjetore prej 2.3 përqind, duke arritur në 328.7 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, vlera e importit të shërbimeve shënoi rënie prej 16.7 përqind dhe arriti në 157.5 milionë euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportuara, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit u karakterizuan me rritje vjetore prej 7.0 përkatësisht 23.0 përqind, përderisa kategoria e shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënoi rënie prej 18.6 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, dy kategoritë kryesore, gjegjësisht shërbimet e transportit dhe të udhëtimit, shënuan rritje prej 16.4 përkatësisht 20.7 përqind.

Deri në qershor 2016, llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rënie prej 30.2 përqind. Përderisa bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve⁵ u zvogëluar për 10.2 përqind, bilanci i të ardhurave të realizuara nga investitorët e huaj direkt shënoi rritje për 11.0 përqind.

Figura 13. Remitencat, në milionë euro



Bilanci i të ardhurave dytësore u zvogëluar për 4.5 përqind në qershor 2016, zvogëlim që kryesisht i atribuohet nivelit më të ulët donacioneve dhe granteve të ndryshme, por edhe reduktimit të shpenzimeve nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Gjithashtu, remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, në gjashtë muajt e parë të vitit 2016 shënuan vlerën prej 329.6 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.7 përqind (figura 13).


Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat

⁵ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

dërgohen 37.7 përqind përkatësisht 21.6 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë, deri në qershor 2016, arritën vlerën prej 97.5 milionë euro, që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vlerën prej 163.0 milionë euro të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit 2015. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me zvogëlim të vlerës u karakterizuan të dy format e IHD-ve, përfshirë kapitalin dhe fondin e investimeve në aksione, si dhe investimet në instrumentet e borxhit (figura 14). Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 77.4 përqind të gjithsej IHD-ve, shënoi vlerën prej 75.5 milionë euro që është për 35.3 përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 22.0 milionë euro, një zvogëlim kundrejt vitit paraprak prej 52.5 përqind.


Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Zvogëlim i IHD-ve në Kosovë u evidentua sidomos në sektorin e patundshmërive dhe në sektorin e shërbimeve financiare (figura 15).

Figura 15. Struktura e IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik, në milionë euro




Në anën tjetër, sektorët e ekonomisë që u karakterizuan me rritje të IHD-ve ishin sektori i shërbimeve tregtare dhe sektori i bujqësisë.

Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.08 miliardë euro deri në qershor 2016, që përkon me një rritje vjetore prej 7.3 përqind. Rritja e aktivitetit të sistemit financiar në vend kryesisht i'u atribuua rritjes së asetëve të sektorit bankar dhe sektorit pensional, sektor që njëkohësisht kanë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar në vend (figura 16).

Figura 16. Asetet e sistemit financiar të Kosovës, në përqindje



Burimi: BQK (2016)


Deri në qershor 2016, vlera e asetëve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës ishte 1.32 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind (rritje prej 26.5 përqind në qershor 2015). AJN-të e sektorit mikrofinanciar ishin segmenti i vetëm që shënoi bilanc negativ prej 5.1 përqind të gjithsej AJN-ve të sistemit financiar.

Sektori Bankar

Asetet

Vlera e asetëve të sektorit bankar deri në qershor 2016 arriti në 3.43 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 5.0 përqind (figura 17). Zgjerimi i portofolios së kredive ishte kontribuuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar. Rritja e aktivitetit të sektorit bankar reflekton ecurinë e qëndrueshme të rritjes së depozitave, si një burim i rëndësishëm financimi për aktivitetin kreditues në vend.

Figura 17. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në gjysmën e parë të vitit 2016, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u karakterizua me ngadalësim të rritjes në 2.1 përqind (9.5 përqind në qershor 2015), si rezultat i rënies së shënuar në investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (për 6.2 përqind), si dhe rënies së investimeve në letrat me vlerë në kategorinë 'tjera' (27.0 përqind). Ndërsa, rënia në këto dy kategori kryesisht u neutralizua nga rritja e investimeve në letrat me vlerë të qeverive të huaja (10.1 përqind). Këto zhvillime mund të jenë kryesisht pasojë e kërkesës më të ulët për financim nga Qeveria e Kosovës krahasuar me ofertën nga periudha e njëjtë e vitit paraprak që


ishite 2.2 herë më shumë se vlera e pranuar e letrave me vlerë. Kjo mund të ketë ndikuar që bankat të cilat vepronë në Kosovë t'i rrisin investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja.

Paraja e gatshme u karakterizua me rritje prej 31.2 përqind, për dallim nga bilanci me BQK-në që shënoi rënie prej 1.1 përqind. Rritja e theksuar e kësaj kategorie mund të jetë ndikuar nga ngadalësimi i rritjes së letrave me vlerë, si dhe nga rënia e theksuar e bilancit me bankat komerciale (16.4 përqind deri në qershor 2016).

Kreditë

Kreditë e sektorit bankar përshpejtuan rritjen krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në qershor 2016, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.17 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.4 përqind (6.1 përqind në qershor 2015) (figura 18). Rritja e kreditimit gjatë vitit 2016 kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi, si dhe përmirësimit të kushteve të kreditimit nga sektori bankar.


Figura 18. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Kategoria me rritjen më të madhe të kredive ishte kategoria e ekonomive familjare, që shënoi rritje vjetore prej 15.2 përqind në qershor 2016, duke paraqitur kështu edhe kontribuesin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të sektorit bankar (figura 19). Në kuadër të kredive të reja ndaj ekonomive familjare, kreditë konsumuese u karakterizuan me rritje prej 19.4 përqind, pasuar nga rritja prej 10.6 përqind e kredive hipotekare, dhe 25.0 përqind nga rritja e kredive me kushte favorizuese.


Figura 19. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2016)

Për dallim nga kreditë për ekonomitë familjare të cilat përshpejtuan ritmin e rritjes, kreditë për ndërmarrjet shënuan një rritje vjetore prej 5.2 përqind e cila është e ngjashme me rritjen e regjistruar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pasuar nga ato për prodhimtari, dhe ndërtimtari (figura 20).


Figura 20. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (Qershor 2016)



Burimi: BQK (2016)

Deri në qershor 2016, kreditimi i të gjithë sektorëve shënoi rritje, përjashtuar atë të prodhimit dhe të ndërtimitarisë që u karakterizuan me rënie (0.6 përkatësisht 2.2 përqind) (figura 21). Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 17.4 përqind, ku kategoria e kredive investuese dhe jointestuese regjistruan rënie vjetore prej 24.3 përkatësisht 6.7 përqind. Kjo rënie kryesisht reflekton rënien e kredive të reja ndaj sektorit të shërbimeve (27.9 përqind) dhe të industrisë të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të kredive të reja ndaj ndërmarrjeve (78.1 përqind).


Figura 21. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë afatmesme, më konkretisht nga kreditë me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite'. Megjithatë, kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' dhe 'mbi 10 vite' kanë vazhduar të përcjellin një trend rritës (figura 22).

Figura 22. Kreditë sipas afatit të maturimit, në



Burimi: BQK (2016)

Gjatë TM2 2016, përshpejtimi i aktiviteti kreditues i'u atribua kryesisht rritjes më të shpejtë të kredive për ekonomitë familjare. Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik ka mbetur e ngjashme me tremujorët paraprak, përderisa struktura e kredive sipas afatit të maturimit ka shfaqur tendencë të rritjes së kredive me afat më të gjatë maturimi.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 78.5 përqind të gjithsej detyrimeve, duke përfaqësuar kështu burimin kryesorë të financimit të aktivitetit të sektori bankar. Pjesë përbërëse shumë të rëndësishme të kategorisë së detyrimeve vazhdojnë të


mbesin edhe kategoria e 'obligimeve tjera' dhe 'bilanci me bankat komerciale'.

Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 15.1 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes vlerës së fitimit të mbajtur në 88.2 milionë euro (40.4 milionë në qershor 2015).

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të shënojnë rritje, megjithëse me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhat paraprake. Në qershor 2016, vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar arriti në 2.69 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.6 përqind (figura 23).

Figura 23. Depozitat, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Ritmi i rritjes së gjithsej depozitave diktohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare, kategori kjo që deri në qershor 2016 regjistroi një normë vjetore të rritjes prej 5.2 përqind (6.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të

dominojnë strukturën e gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve (figura 24).


Figura 24. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Në të njëjtën periudhë, depozitat e ndërmarrjeve, që kanë një pjesëmarrje prej 20.8 përqind në gjithsej depozitat e sektorit, gjithashtu shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar prej 3.7 përqind (7.3 përqind).

Figura 25. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të strukturës së depozitave sipas afatit të maturimit, ka vazhduar rritja e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme, gjë që reflekton nivelin relativisht të ulët të normave të interesit në depozita. Në qershor 2016, depozitat e transferueshme rritën


pjesëmarrjen në 55.9 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar të Kosovës (figura 25).

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, depozitat vazhduan të shënojnë rritje, edhe pse me ritëm më të ngadalësuar. Struktura e depozitave vazhdoi të ndryshojë në favor të depozitave të transferueshme, përderisa depozitat e afatizuara dhe ato të kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.

Normat e Interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita vazhdoi të ngushtohet, duke zbritur në 6.2 pikë përqindje në qershor 2016 (figura 25). Norma mesatare e interesit në kredi në qershor 2016 u zvogëlua në 7.2 përqind, krahasuar me 7.6 përqind në qershor 2015 (figura 26). Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita shënoi një rritje, duke u ngritur në 1.0 përqind krahasuar me 0.8 përqind sa ishte në qershor 2015.

Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2016)

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve u zvogëlua në 6.7 përqind. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, normat e interesit në kreditë investuese dhe jo-investuese vazhdojnë të përcjellin trend rënës, por rënia ishte më e theksuar në kreditë jo-investuese (1.1 pikë përqindje).


Figura 27. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2016)

Në qershor 2016, vërehet një ndryshim edhe më i vogël i normave të interesit në kredi mes sektorëve ekonomik, për dallim nga periudhat paraprake. Në këtë periudhë normat e interesit në sektorë të ndryshëm ekonomik qëndrojnë në një nivel relativisht të ngjashëm ndaj njëra tjetrës. Ky përafrim vjen kryesisht si rezultat i rënies më të theksuar të normave të interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë dhe 'sektorëve tjerë', përderisa sektori i industrisë dhe i shërbimeve përcjellën trend rënës më të ngadalësuar (figura 28).

Figura 28. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2016)

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare, në qershor 2016, norma mesatare e interesit u zvogëluar në 7.8 përqind. Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese ishte 8.0 përqind, përderisa norma e interesit të kredive hipotekare ishte 6.2 përqind.

Normat e interesit në depozita

Rritja e normës mesatare të në gjithsej depozitat kryesisht reflekton rritjen e normës së interesit në depozitat ndaj ndërmarrjeve, përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rënie të lehtë (figura 29).


Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2016)

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve arriti në 1.5 përqind, një rritje prej 0.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 30).

Figura 30. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive



Burimi: BQK (2016)

Më specifikisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve.


Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rënie, duke zbritur në 0.7 përqind, nga 0.8 përqind sa ishte në qershor 2015. Në kuadër të kësaj kategorie, në depozitat e afatizuara u shënuar rënie e lehtë e normës së interesit, përderisa norma e interesit në depozitat e kursimeve dhe atyre të

transferueshme nuk kanë pasur ndryshime domethënëse (figura 30).

Performanca e sektorit bankar⁶

Rënia e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve të sektorit bankar në gjysmën e parë të vitit 2016 ndikuan që profiti të shënojë një rënie vjetore prej 15.9 përqind (figura 31).


Figura 31. Profiti neto i sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

Të hyrat e sektorit bankar vazhdojnë të ndjekin një trend rënës. Në qershor 2016, ato shënuan vlerën prej 113.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.9 përqind. Rënia e të hyrave kryesisht i atribuohet rënies së të hyrave nga interesi si pasojë e zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi (figura 32).


Figura 32. Vlera e të hyrave sipas kategorive, rritja vjetore



Burimi: BQK (2016)

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 76.0 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.6 përqind. Në rritjen e gjithsej shpenzimeve, kontributin kryesor e kishte rritja e shpenzimeve të jo interesit (figura 33). Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe rritjen më të lartë shënuan nënkategoria e shpenzimeve të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi. Rritja e theksuar e kreditimit gjatë kësaj periudhe, mund të ketë shtyrë bankat që të ndajnë vlerë më të lartë të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi.

Figura 33. Vlera e shpenzimeve sipas kategorive dhe rritja vjetore e shpenzimeve




Burimi: BQK (2016)

Si pasojë e rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve në këtë gjashtëmuor, raporti i

⁶ Bazuar në të dhënat e paaudituar.


shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit është përkeqësuar në 66.8 përqind, nga 62.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 34).

Figura 34. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Zvogëlimi i profitit deri në qershor 2016 ka ndikuar në rënien e treguesve të profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), duke e ndërprerë kështu trendin rritës që kishin shënuar gjatë tri viteve të kaluara. Treguesi i profitabilitetit KMA shënoi rënie në 2.5 përqind, përderisa KMK shënoi rënie në 20.6 përqind (figura 35).

Figura 35. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




*Për 2016 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në qershor 2016
Burimi: BQK (2016)

Treguesit e shëndetit financiar

Deri në qershor 2016, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë e sektorit u zvogëlua në 5.3 përqind, kryesisht si rezultat i rënies vjetore prej 21.0 përqind të vlerës së kredive joperformuese, si dhe përsheptimit të rritjes së gjithsej kredive (figura 36). Kjo ndihmoi edhe në rritjen e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione, e cila u rrit lehtësisht në 119.9 përqind.


Figura 36. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2016)

Sektori vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit që qëndroi në 18.7 përqind në qershor 2016. Po ashtu, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion fuqishëm të likuiditetit (figura 37).

Figura 37. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Burimi: BQK (2016)


Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016 sektori bankar shënoi rënie të profilit si pasojë e zvogëlimit të të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve. Cilësia e portofolit kreditor shënoi përmirësim të mëtutjeshëm, duke arritur normën më të ulët të kredive joperformuese të regjistruar në vitet e fundit. Për më tepër, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizmit dhe pozicion të fuqishëm të likuiditetit.

Sektori pensional

Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 1.33 miliard euro deri në qershor 2016, një rritje prej 12.4 përqind krahasuar me vitin paraprak (figura 38).

Ritmi më i ngadalshëm i rritjes së aseteve në krahasim me vitin paraprak është kryesisht pasojë e performancës së kthimit në investime, përderisa arkëtimet nga kontributet e reja vazhduan të shënojnë rritje.

Figura 38. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Gjatë kësaj periudhe, sektori pensional realizoi kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 33.6 milionë euro por, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vlera e kthimit është për 10.8 përqind më e ulët. Vlera më e ulët e kthimit nga investimet ishte pasojë e lëkundjeve në tregjet financiare ndërkombëtare, të ndikuara kryesisht nga rënia e çmimit të naftës gjatë muajve të parë të këtij viti dhe rezultati i papritur i referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për dalje nga BE-ja.


Vlera e arkëtimeve të reja arriti në 74.3 milionë euro në krahasim me vlerën e arkëtimeve deri në qershor 2015 prej 66.7 milionë euro.

Sektori pensional deri në qershor 2016 shënoi rritje më të ngadalshme të aseteve, në krahasim me vitin paraprak. Shkak për këtë kryesisht ishte performanca më e dobët e investimeve të fondeve në sektorin e jashtëm si rrjedhojë e zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Ndërsa, arkëtimi i kontributeve të reja shënoi përmirësim në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve që përfaqëson rreth 3.2 përqind të gjithë asetëve të sistemit financiar, në qershor 2016 shënoi rritje vjetore prej 8.3 përqind (figura 39).

Figura 39. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2016)

Sigurimet jo-jetë përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit (90.4 përqind të gjithë asetëve të sektorit), dhe shënuan rritje vjetore prej 8.5 përqind. Pjesa e mbetur e asetëve përbëhet nga sigurimet jetë, asetet e të cilave shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind.

Vlera e gjithëj primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve deri në qershor 2016 ishte për 1.9 përqind më e lartë se sa në vitin paraprak. Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.7 përqind të gjithëj primeve të shkruara. Vlera e tyre gjatë kësaj periudhe ishte 39.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.0 përqind. Ndërsa, pjesa e mbetur e primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit jetë të cilat arritën vlerën 1.4 milionë euro (rënie vjetore prej 0.3 përqind).

Në anën tjetër, gjithëj dëmet e paguara, ku përfshihen kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), deri në qershor 2016 shënuan rënie vjetore prej 9.3 përqind (rritje prej 17.4 përqind në TM2 2015). Zvogëlimi i vlerës së dëmeve të paguara krahas rritjes së primeve të shkruara, rezultoi në rënie të raportit të gjithëj dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 40).

Figura 40. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2016)

Performanca e sektorit të sigurimeve

Të hyrat neto të sektorit të sigurimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 shënuan rënie vjetore prej 1 përqind, ndërsa shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 24 përqind. Si rrjedhojë e kësaj, humbja e regjistruar nga sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe ishte 11.5 milionë euro (-2.5 milionë deri në qershor 2015).⁷ Në këtë periudhë, sigurimi jo-jetë regjistroi humbje prej 11.7 milionë euro, ndërsa sigurimi jetë regjistroi fitim në vlerë prej 186.2 mijë euro.

⁷ Bazuar në të dhënat e paaudituar.

Rënia vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 15.3 përqind, dhe rritja prej 25.2 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në përkeqësimin e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 77.6 përqind në qershor 2016 (114.6 në qershor 2015), përderisa raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 68.4 përqind (99.0 në qershor 2015). Rritja e theksuar e investimeve në letrat me vlerë ka ndikuar në rënien e parasë së gatshme dhe ekuivalentët e saj. Në anën tjetër, niveli më i larët i rezervave teknike të mbajtura është rezultat i rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe.

Sektori i sigurimeve deri në qershor 2016 shënoi rritje të primeve shkruara, kurse vlera e dëmeve të paguara shënoi rënie. Megjithatë, performanca financiare e këtij sektori vazhdoi të jetë e brishtë, duke u karakterizuar me thellim të humbjes gjatë kësaj periudhe.


Sektori mikrofinanciar

Asetet

Sektori mikrofinanciar gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 shënoi rritje të theksuar të aseteve, që ishte më e shprehur në periudhën prill-qershor. Vlera e aseteve të sektorit arriti në 136.0 milionë euro në qershor 2016, që përkon me rritje vjetore prej 16.9 përqind (figura 41). Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht në huamarrjen nga sektori i jashtëm. Deri në qershor 2016, gjithsej huamarrjet e jashtme arritën vlerën prej 68.2 milionë euro, që

përkon me rritje vjetore prej 9.4 përqind. Rritja e huamarrjeve prej sektorit të jashtëm është reflektuar kryesisht në rritjen e theksuar të aktivitetit kreditor (25.2 përqind) gjatë TM2 2016.


Figura 41. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2016)

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar vazhdon të dominohet nga kreditë (71.8 përqind) dhe lizingjet (16.2 përqind) (figura 42).

Figura 42. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar (Qershor 2016)




Burimi: BQK (2016)

Kreditë

Deri në qershor 2016, vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar arriti në 97.6 milionë euro, që paraqet rritje të konsiderueshme vjetore prej 25.2 përqind (figura 43).


Figura 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Kontributin më të madh në rritjen e kredive të lëshuara nga sektori mikrofinanciar e kishte kategoria e kredive ndaj ekonomive familjare, e cila përfaqëson 67.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit. Deri në qershor 2016, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 28.7 përqind, që tregon një rimëkëmbje të konsiderueshme krahasuar me rënien vjetore prej 0.4 përqind gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Rritje e theksuar u regjistrua edhe te kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat shënuan një normë vjetore të rritjes prej 18.7 përqind (9.4 përqind deri në qershor 2015). Kreditë e destinuar për sektorin e bujqësisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore në periudhën raportuese (34.0 përqind), pasuar nga sektori i industrisë (27.0 përqind) (figura 44).


Figura 44. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë për nga pesha (16.2 përqind) në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar, përkundër rënies vjetore prej 4.1 përqind që shënuan në TM2 2016 (figura 45).

Figura 45. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar




Në kuadër të strukturës së lizingjeve, rënia ishte më e theksuar te ndërmarrjet (-8.3 përqind), përderisa lizingjet për ekonomitë familjare shënuan rënie vjetore prej 0.2 përqind.

Normat e Interesit


Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në qershor 2016 zbriti në 21.9 përqind. Rënia e normës së interesit ishte më e theksuar te kreditë ndaj ndërmarrjeve (figura 46).

Figura 46. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezultoi të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, përderisa sektori i bujqësisë vijoi të ketë normën më të lartë të interesit (figura 47).


Figura 47. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Performanca e sektorit mikrofinanciar


Deri në qershor 2016, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 1.6 milion euro, një rritje prej 33.4 përqind kundrejt vitit paraprak si rezultat i rritjes më të madhe të të hyrave në krahasim me rritjen e shpenzimeve (figura 48).

Figura 48. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Rritja e profitit të realizuar në gjysmën e parë të vitit 2016 ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit (figura 49).


Figura 49. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese prej 4.3 përqind, dhe me nivel të kënaqshëm të

mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizioneve prej 159.7 përqind (figura 50).

Figura 50. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2016)

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përshejtim të theksuar të aktivitetit kreditor në gjashtë muajt e parë të vitit 2016. Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, por vazhdojnë të mbeten në nivel relativisht të lartë. Cilësia e portofolit kreditor ka shënuar përmirësim të mëtejshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, deri në qershor 2016, janë mbajtur 11 ankande për emetimin e letrave me vlerë, në vlerë të shpallur nominale prej 250.0 milionë euro.

Deri në qershor 2016, Qeveria e Kosovës ka emetuar numër më të vogël të bonove të thesarit dhe numër më të madh të fletë-obligacioneve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, vlera e shpallur e letrave me vlerë mbeti e njëjtë për bonot e thesarit dhe u rrit për fletë-obligacione (tabela 2).

Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës


Periudha	Numri i bonove të thesarit	Vlera e shpallur bonove të thesarit	Numri i fletëobligacioneve	Vlera e shpallur e fletëobligacioneve
Janar-Qershor 2013	10	144.0	-	-
Janar-Qershor 2014	9	200.0	2	22.0
Janar-Qershor 2015	8	160.0	3	55.0
Janar-Qershor 2016	7	160.0	4	90.0

Burimi: MF (2016)

Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës tregon tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me maturitet afatshkurtër, në letra me vlerë me maturitet afatgjatë.

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë edhe gjatë TM2 2016 vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletë obligacionet me afat maturimi dy vite (figura 51).

Figura 51. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje




Burimi: BQK (2016)

Që nga fillimi i funksionimit të tregut të letrave me vlerë në vitin 2012, shumica e ofertuar nga pjesëmarrësit në shumicën e rasteve ka tejkaluar shumën e shpallur në ankande nga Ministria e Financave. Në qershor 2016, raporti në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të shpallur në ankande

ishte 2.21 herë. Ky raport është më i lartë krahasuar me vitin paraprak (1.53 herë deri në qershor 2015) kryesisht si rezultat i ofertimit më të lartë nga ana e pjesëmarrësve duke reflektuar interesimin e lartë të subjekteve pjesëmarrëse (kryesisht të sektorit bankar) për të investuar në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Në qershor 2016, norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka shënuar rënie në 1.0 përqind (1.8 përqind në qershor 2015). Në këtë periudhë, vetëm norma e interesit për letrat me vlerë me afat maturimi ‘mbi 5 vite’ ka shënuar rritje.

Figura 52. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2016): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 15 TM2 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2016):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2016):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2016): Metal Prices database.

FAOUN (2016): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2016): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2016): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2015	Qershor 2016
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	-0.4%	0.0%
Çmimet (fondi i periudhës)	-0.4%	-0.3%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	646.1	736.7
Shpenzimet (në milionë euro)	667.2	716.4
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-21.1	20.3
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,731.4	5,075.6
prej të cilave: Bankat	3,269.6	3,432.1
Kredi	2,005.2	2,173.5
Depozita	2,574.6	2,692.8
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.6	7.2
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	0.8	1.0
Hendeku i normës së interesit	6.8	6.2
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-208.8	-337.9
prej të cilave: remitencat e pranuar	338.9	329.6
Llogaria financiare	-164.4	-92.7
Investimet e huaj direkte në Kosovë	163.0	97.5
Investimet portfolio, net	55.1	120.7
Investimet tjera, net	-66.4	-179.0
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net*	382.6	151.9
Asetet	4419.2	4605.7
Detyrimet	4036.6	4453.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1733.7	1927.7
Borxhi i jashtëm privat	1333.4	1469.6
Borxhi i jashtëm publik	400.4	458.1

Burimi:

1/ ASK (2016).

2/ MF (2016).

3/ BQK (2016).

*Për PNI dhe borxhin e jashtëm, të dhënat e fundit janë deri në mars 2016.

